



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vendimi me numër të referencës: **BD-234/1**

Vërejtje:

Ky Vendim nuk është publikuar për shkak se ka të bëjë me çështje të brendshme, qoftë organizative apo procedurale të Agjencisë dhe përmban informacione të individëve të caktuar që mund të bie ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji 03/L-172).

Agjencia ju njofton se në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (L-03/L-215), palët e interesuara mund të parashtrojnë kërkesë specifike me arsyetim përkatës për qasje në këto Vendime tek Zyrtari përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike.



Nr. Ref. BD-234/2

Në bazë të neneve 6.1.1, 6.1.2 dhe 15.2.4 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores nr. 07/2025 për Administrimin Direkt Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare në mbledhjen e mbajtur me datë 25 qershor 2026 nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Të shpallet konkurs publik i rekrutimit për Bord të Përkohshëm të Ndërmarrjes Shoqërore Inex Sharr Planina Brezovicë me përbërje prej pesë (5) anëtarësh.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit të Agjencisë për shpalljen e konkursit për rekrutim të Bordit të Përkohshëm Menaxhues të NSH Inex Sharr Planina në Brezovicë. Menaxhmenti këtë propozim e ka bazuar në faktin që Bordit të kaluar i ka kaluar mandati dhe duhet të plotësohet vakumi në këtë organ.

Bordi u bazua në faktin se konstituimi i Bordit të Përkohshëm të ndërmarrjes Brezovica përmes procedurës konkurruese përmes shpalljes së konkursit publik që do të ketë ndikim pozitiv në afarizmin e ndërmarrjes, prandaj Bordin i Agjencisë konsideron që për shkak të rëndësisë së zhvillimit të aktivitetit të ndërmarrjes pa pengesa.

Pas zhvillimit të procedurave të tjera të konkursit si themelimi i Komisionit përzgjedhës, përzgjedhja e kandidatëve që i plotësojnë kushtet për intervistim, pastaj intervistimi, poentimi etj dhe në fund bëhet propozimi i kandidatëve të sipër cekur për emërim.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordin shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente brenda afatit ligjor.

Prishtinë, më 25 qershor 2026.


Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-234/3

Në bazë të nenit 15.2.15 dhe 20.2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 25 qershor 2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet buxheti për vitin 2027 dhe parashikimet 2028-2029.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për miratimin e buxhetit të AKP-së për vitin 2027 dhe parashikimet 2028-2029. Bordi bëri dy ndryshime në buxhetin e propozuar si në vijim: shtoi 100,000.00€ për konsulentë ligjorë për titullin: Transformimi ligjor i AKP-së; dhe rriti buxhetin në 72,000.00€ për Marrëveshjen me BSPK-në.

Nga Ministria e Financave, me datën 19 maj 2026 është pranuar Qarkorja e parë buxhetore Nr. 2027/01 përmes së cilën Organizatat buxhetore janë të obliguara që të fillojnë përgatitjet e para të përpilimit të kërkesës buxhetore për vitin 2027 dhe parashikimet 2028-2029. Për të identifikuar sa më mirë kërkesat buxhetore për vitin 2027 të programeve të AKP-së, Departamenti i Financave dhe Buxhetit (DFB) i ka njoftuar të gjithë Mbajtësit e Buxhetit/Udhëheqësit Departamenteve dhe Divizioneve brenda AKP-së dhe ka kërkuar të përgatisin kërkesat e tyre buxhetore dhe ti dorëzojnë në DFB. Pas pranimit të kërkesave DFB ka analizuar secilën linjë buxhetore për vitin 2027 si dhe parashikimet e hershme për vitet 2028-2029. Gjatë procesit të përgatitjes së kërkesës buxhetore janë analizuar edhe shpenzimet e dy viteve të kaluara, shpenzimet e deri tanishme si dhe kodet ekonomike të cilat janë të nevojshme për realizimin e shpenzimeve gjatë vitit vijues dhe në bashkëpunim të ngushtë me Mbajtësit e Buxhetit/Udhëheqësit e Departamenteve dhe Divizioneve janë korrigjuar/plotësuar kërkesat dhe është finalizuar kërkesa buxhetore për vitin 2027 dhe parashikimet 2028-2029.

Bordi shqyrtoi buxhetin e propozuar nga Menaxhmenti, dhe duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 25 qershor 2026.


Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-234/4

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 qershor 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Plotësohet Vendimi nr. BD-212/5, datë 21.10.2024.
- II. Autorizohen z. Burim Leci u.d.DE (pozita primare ZDE Operativë) dhe z. Albert Muja, Udhëheqës i Ekipit për Likuidim në Zyrën Rajonale Mitrovicë, që në emër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe të NSH "Trepça – Ndërmarrje në Administrim të AKP-së", si dhe njërive të saj jothelbësore nën administrimin e AKP-së, të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë dhe institucioneve tjera kompetente, përfshirë por pa u kufizuar në ndryshimin dhe azhurnimin e numrit të punëtorëve, kapitalit, veprimtarive ekonomike dhe të dhënave të tjera të regjistrimit. Autorizimi vlen përderisa dy zyrtarët e sipër cekur janë në marrëdhënie pune në AKP.
- III. Autorizohet Kryesuesi që në të ardhmen të lëshoj autorizime të tilla si ky dhe të mos ketë nevojë që çështja të sjellët përsëri në Bord.
- IV. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv të nënshkruajë autorizimet dhe dokumentet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin për ndryshimin e Vendimit nr. BD-212/5, datë 21.10.2024, ku Bordi i Drejtorëve kishte autorizuar z. Albert Muja për kryerjen e veprimeve të caktuara administrative në emër të NSH "Trepça – Ndërmarrje në Administrim të AKP-së". Gjatë implementimit të këtij vendimi është konstatuar se autorizimet ekzistuese nuk përfshijnë kompetencat e nevojshme për realizimin e ndryshimeve në regjistrin e bizneseve pranë ARBK-së, përkatësisht për: ndryshimin dhe azhurnimin e numrit të punëtorëve; ndryshimin dhe azhurnimin e kapitalit; ndryshimin dhe plotësimin e veprimtarive ekonomike; ndryshimin e të dhënave të tjera të regjistrimit; nënshkrimin dhe dorëzimin e formularëve dhe dokumentacionit përkatës pranë ARBK-së dhe institucioneve tjera kompetente. Duke qenë se certifikata e biznesit e NSH "Trepça – Ndërmarrje në Administrim të AKP-së" vazhdon të figurojë aktive dhe paraqitet nevoja për azhurnimin e vazhdueshëm të të dhënave të regjistrimit, u konsiderua e domosdoshme që autorizimet ekzistuese të zgjerohen, në mënyrë që të sigurohet funksionimi normal administrativ dhe përfaqësimi efektiv i ndërmarrjes dhe njërive të saj jothelbësore. Autorizimi u zgjerua edhe me një zyrtar që është z. Burim Leci pasi që Bordi konsideroi se kështu do të jetë më praktike. Po ashtu, për shkak të kufizimeve të autorizimit aktual, ndryshimet e nevojshme në ARBK nuk mund të realizohen, gjë që mund të shkaktojë mospërputhje ndërmjet gjendjes faktike dhe të dhënave të regjistruara. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 25 qershor 2026


Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-234/5

Në bazë të nenit 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 25 qershor 2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohen propozimi i Menaxhmentit përkatësisht aprovohet Rregullorja e re e plotësuar me nr. 01/2026 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.


Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për amadamentimin e aktit nënligjor të cekur në paragrafin I të këtij vendimi.

Ky vendim është aprovuar duke pasqyruar faktin se gjatë diskutimeve të Bordit u konstatua se është e nevojshme ndryshimi i rregullorës në fjalë përkatësisht neni 10.1.4 ku u përcaktua se kur paraqitet kërkesë për qiramarrje nga palët e interesuara, duhet të këtë arsyeshmëri konkrete të ndikimit në mirëqenie, zhvillim ekonomik apo social, si dhe të jetë në funksion të interesit publik, dhe se kjo arsyeshmëri duhet të mbështetet formalisht me shkresë përkrahëse nga institucioni qendror i Republikës së Kosovës. Shkresa përkrahëse duhet të jetë e nënshkruar, vulosur dhe e protokolluar nga institucioni përkatës qendror.

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 25 qershor 2026.


Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-234/6

Në bazë të neneve 5.12 dhe 15.2.17 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas diskutimeve sipas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e statusit të ndërmarrjeve të caktuara (KPS), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 25 qershor 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Raporti Shqyrtues i Komisionit të Kërkesës për Përcaktimin e Statusit, KPS1544/MIT167, sipas së cilit konstatohet se “Të mirat furnizuese të ndërmarrjes Trepça” – Aseti në Mitrovicë/Kosovë – KPS 1544/MIT167, si dhe çdo aset i ndërmarrjes që do të identifikohet në të ardhmen, janë në pronësi shoqërore dhe BIEN nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesës për Përcaktimin e Statusit të Entitetit (SDR-KPS), ku pas shqyrtimit të lëndës për Ndërmarrjen “Të mirat furnizuese të ndërmarrjes Trepça” – aset i Mitrovicë/Kosovë - KPS 1544/MIT167 u konstatua se asetet e ndërmarrjes së lartcekur si dhe çdo aset tjetër i ndërmarrjes që do të identifikohet në të ardhmen janë pronësi shoqërore dhe bien nën juridiksionin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Në përputhje me nenin 5.1.1.2 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Agjencia mund të ushtrojë autoritetin e saj për administrimin, shitjen apo likuidimin e pronave vetëm në rastet kur ndërmarrjet apo asetet përkatëse kanë status të pronës shoqërore.

Aseti në fjalë, bazuar në të dhënat që posedon Agjencia, nuk paraqitet si ndërmarrje e organizuar dhe nuk figuron si pjesë e njësisë të ish-KXMK “Trepça”, përveç faktit se në certifikatën e pronësisë emërtimi i tij përmban referencën ndaj Trepçës. Po ashtu, ky aset nuk është pjesë e Trepça Sh.A., siç është përcaktuar me Ligjin për Trepça Sh.A. dhe Statutin e saj.

Nga Çertifikata e Pronësisë e aseteve të ndërmarrjes “Dobro Službe Snabdevanje Preduz. Trepče” (“Të Mirat Furnizuese të Ndërmarrjes Trepça”), e shkarkuar nga shërbimet digjitale të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, rezultojnë se parcelat e lartpërmendura kanë qenë të regjistruara si pronë shoqërore së paku nga viti 1989 dhe vazhdojnë të evidentohen si të tilla edhe aktualisht.

Veprime shtesë për hulumtimin e dokumentacionit lidhur me ndërmarrjen dhe asetet e saj janë ndërmarrë nga Zyra Rajonale e AKP-së në Mitrovicë, mirëpo deri më tani nuk është pranuar asnjë përgjigje nga institucionet relevante. Megjithatë, është vlerësuar se dokumentacioni i siguruar është i mjaftueshëm për vendosjen e kësaj lënde në Bord, duke pasur parasysh se është siguruar Çertifikata e Pronësisë, në të cilën parcelat e ndërmarrjes në fjalë vazhdojnë të figurojnë si pronë shoqërore edhe pas transferimit të titullarit të pronave të ish-KXMK “Trepça” dhe njësisë të saj në emër të Trepça Sh.A.

Sipas të dhënave të Njesisë për Regjistrimin e Ankesave në AKP, nuk është e regjistruar asnjë kërkesë, ankesë apo pretendim pronësor lidhur me ndërmarrjen “Të Mirat Furnizuese të Ndërmarrjes Trepça” – aset i Mitrovicë.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Në përputhje me nenet 5, 6 dhe 15.2.17 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115) Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 25 qershor 2026


Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-234/7

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 qershor 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës me numër KB-1839/005 LMS-MIT019-0303 e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 09.06.2026 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH NN "Kosova" Vushtrri.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 09.06.2026 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "NN "Kosova" Vushtrri.

nuk ka paraqitur kërkesë për blerjen e banesës sipas formularit standard. Lënda është siguruar nga Data baza e LMS në Komision për Banesa, e cila është pranuar nga ZR Gjilani me datë 10.01.2025. Adresa e banesës e paraqitur nga pala është: Lagja- Kalaja- 7A, Hyrja I, Kati III, Vushtrri. Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave"), komisioni lidhur me kërkesën e

ka vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe konstatoi se dokumentacioni i prezantuar nga pala është i pamjaftueshëm për aprovim të kërkesës. Përkatesisht i gjithë dokumentacioni mbështetës i dorëzuar nga pala është jo relevant për vendim meritor. Mungojnë dëshmitë vendimtare si vendimi mbi ndarjen e banesës si dhe Kontrata e shfrytëzimit të përhershëm të banesës me BVI banesore. Për më tepër, sipas konfirmimit të Agjencisë për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, kërkesa e palës në fjalë është refuzuar nga Habitati.

Andaj, Komisioni ka konstatoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Në përputhje me të lartcekurat, Komisioni rekomandoi që kërkesa e palës të refuzohet.

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 25 qershor 2026.



Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-234/8

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banësive mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 qershor 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës me numër KB-1841/007 (LMS-PEJ013/0970) e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banësive të datës 9.06.2026 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "SP.PIK. Pejë" –DP "Fabrika e Alkoolit Pejë (Fabrika e "Birrës Pejë").
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banësive të datës 09.06.2026 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "SP.PIK. Pejë" –DP "Fabrika e Alkoolit Pejë (Fabrika e "Birrës Pejë").

ka paraqitur kërkesë pranë Autoritetit të Likuidimit të ndërmarrjes NSH "Fabrika e Birrës Pejë" më 08.06.2007, duke bashkëngjitur disa akte gjyqësore mbështetëse. Pala nuk ka paraqitur kërkesë për blerjen e banesës sipas formularit standard të paraparë për këtë procedurë. Lënda është siguruar nga baza e të dhënave LMS në Komisionin për Banesa. Sipas dokumentacionit të paraqitur, banesa për të cilën pretendohet e drejta, gjendet në rrugën ish "Marshall Tito", objekti banesor "Terolit 1", banesa nr. 18, në Pejë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 65.02 m².

Bazuar në nenin 7, paragrafi 2.1 të Ligjit Nr. 04/L-061 për Shitjen e Banësive për të cilat ekziston e drejta banesore (në tekstin e mëtejshëm: "Ligji për Shitjen e Banësive"), Komisioni ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga dhe ka vlerësuar të gjitha provat e bashkëngjitura kërkesës.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioni ka konstatuar se provat e paraqitura nga pala janë të pamjaftueshme për aprovimin e kërkesës. Konkretisht, dokumentacioni mbështetës i dorëzuar nuk paraqet dëshmi relevante dhe të mjaftueshme për marrjen e një vendimi meritore. Në veçanti, mungojnë dokumentet themelore dhe vendimtare, si vendimi për ndarjen e banesës dhe kontrata për shfrytëzimin e përhershëm të banesës e lidhur me Bashkësinë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI) Banesore. Gjithashtu, pala nuk ju ka përgjigjur ne asnjë formë të komunikimit, dhe nga përpjekjet e Komisionit pala ka rezultuar e paarrtshme për ofrimin e sqarimeve ose dokumentacionit shtesë, përkundër përpjekjeve të Komisionit për të siguruar dëshmi.

Si rrjedhojë, Komisioni vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, të Ligjit për Shitjen e Banësive, në lidhje me nenet 37 dhe 38 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 11/83, 29/86 dhe 42/86). Në përputhje me sa u tha më



sipër, Komisioni rekomandoi që kërkesa e ... për blerjen e banesës të refuzohet si e pabazuar në aspektin ligjor dhe faktik.

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 25 qershor 2026.


Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-234/9

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 qershor 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës me numër KB-1835/001 (LMS-GJI095-0021) e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 09.06.2026 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Banja e Klllokotit", Klllokot, Viti.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 09.06.2026 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "Banja e Klllokotit", Klllokot, Viti.

me datë 16 dhjetor 2010 ka parashtruar pranë Komisionit të Likudimit kërkesën të specifikuar nga ai si kompenzim për çështje banesore në vlerën e përcaktuar nga ai si 40.000 Euro. Ndërkaq Komisioni për Banesa e ka pranuar kërkesën në fjalë nga Zyra Rajonale e Gjilanit me datë 10.01.2025. Adresa e banesës e paraqitur nga pala është: Klllokot Viti, P+4, Kati -2, banesa nr.6.

Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave"), Komisioni lidhur me kërkesën e

ka vlerësuar se mungojnë dokumentet bazë për dëshmimin e posedimit të pronës, përkatësisht: Vendimi për ndarjen e banesës dhe Kontrata për shfrytëzimin e banesës. Për më tepër, Agjencia për Krahësim dhe Verifikim të Pronës përmes përgjigjes së pranuar tek ne me datë 25 shtator 2025, ka konfirmuar që kërkesa e palës në fjalë është refuzuar. Andaj, Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Në përputhje me të lartcekurat, Komisioni rekomandoi që kërkesa e palës të refuzohet.

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 25 qershor 2026.


Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-234/10

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 qershor 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës me numër KB-1842/008 (LMS-PEJ013-00436), e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 9.06.2026 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "SP.PIK. Pejë" –DP "Fabrika e Alkoolit Pejë (Fabrika e "Birrës Pejë").
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 09.06.2026 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "SP.PIK. Pejë" –DP "Fabrika e Alkoolit Pejë (Fabrika e "Birrës Pejë").

nuk ka paraqitur kërkesë për blerjen e banesës sipas formularit standard. Lënda është siguruar nga Data baza e LMS në Komision për Banesa, dhe ka paraqitur kërkesë për blerjen e banesës e cila gjendet në adresën si në vijim: Rruga "Nexhdet Basha", brenda pronës ku gjendet "Fabrika e Birrës" në Pejë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 100m². Banesa është ndarë në shfrytëzim nga Organi i përkohshëm NSH. "SP.PIK. Pejë" –DP "Fabrika e Alkoolit Pejë (PEJ013) me datë 10.10.1991.

Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave"), Komisioni lidhur me kërkesën e

ka vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës dhe konstaton se dokumentacioni i prezantuar nga pala është i pamjaftueshëm për aprovim të kërkesës. Përkatesisht i gjithë dokumentacioni mbështetës i dorëzuar nga pala është jo relevant për vendim meritore. Mungojnë dëshmitë vendimtare si vendimi mbi ndarjen e banesës, Kontrata e shfrytëzimit të përhershëm të banesës me BVI banesore, përkundër verifikimeve të bëra nga Komisioni për kompletim të dokumentacionit. Rrjedhimisht kërkesa është refuzuar edhe me vendim të KPCC/D/R/223/2013 të datës 27 nëntor 2013.

Andaj, Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Në përputhje me të lartcekurat, Komisioni rekomandoi që kërkesa e palës të refuzohet.



Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi/ pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 25 qershor 2026.


Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-234/11

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banësive mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 25 qershor 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës me numër KB-1844/010 (LMS-PEJ093-0216) e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banësive të datës 09.06.2026 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH . OP “Miniera e Boksive” Klinë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banësive të datës 09.06.2026 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH OP “Miniera e Boksive” Klinë.


AKP-ja ka vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara nga pala dhe ka konstatuar se nuk mund të kualifikohet si bartës i së drejtës banesore me arsyetimin se i njëjti nuk ka hyrë në posedim ligjshëm të banesës lëndore nga bartësi i të drejtës së disponimit, në pajtim me nenin 11 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Banimit. Kjo në përputhje edhe me kërkesën e palës, ku është deklaruar se nuk ka hyrë në shfrytëzim të banesës. Andaj, Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, të Ligjit nr. 04/L-061 për Shitjen e Banësive për të cilat ekziston e drejta e banimit, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83-29/86 dhe 42/86). Në përputhje me të lartcekurat, Komisioni rekomandoi që kërkesa e palës të refuzohet.

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padinë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 25 qershor 2026.


Hekuran Nikaj
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-234-12

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 06/L-023 neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 25 qershor 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh PRN009 KB Bujqësia (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës në shumën totale prej 26,623.02 Euro për 14 kreditor në 22 transaksione.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim e shpërndarjes të përkohshme për kreditorët e NSh PRN009 KB Bujqësia (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës në likuidim sipas nenit 41.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.


Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes të Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh PRN009 NSh Bujqësia (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 25 qershor 2026.


Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-234-13

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 06/L-023 neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 25 qershor 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh PRN032 Magjistrala (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës në shumën totale prej 457,934.57 Euro për 99 kreditor në 201 transaksione.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim e shpërndarjes të përkohshme për kreditorët e NSh PRN032 Magjistrala (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës në likuidim sipas nenit 41.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes të Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh PRN032 Magjistrala (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 25 qershor 2026.


Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-234-14

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 06/L-023 neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 25 qershor 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh PRN019 KB Përparimi (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës në shumën totale prej 116,637.47 Euro për 4 kreditor në 4 transaksione.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim e shpërndarjes të përkohshme për kreditorët e NSh PRN019 KB Përparimi nga Rajoni i Prishtinës në likuidim sipas nenit 41.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmblledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes të Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh PRN019 KB Përparimi (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 25 qershor 2026.


Hekuran Nikçi,
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-234-15

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 06/L-023 neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 25 qershor 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh PEJ173 Kombinati Lëkurë Këpucë (në likuidim) nga Rajoni i Pejës në shumën totale prej 27,087.48 Euro për 5 kreditor në 8 transaksione.

II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim e shpërndarjes të përkohshme për kreditorët e NSh PEJ173 Kombinati Lëkurë nga Rajoni i Pejës në likuidim sipas nenit 41.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmblledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes të Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh PEJ173 Kombinati Lëkurë (në likuidim) nga Rajoni i Pejës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 25 qershor 2026.


Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-234/16

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023, , nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 25 qershor 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për NShGJI170 - NewCo XIM Strezovci (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumë prej 40,000.00 € dhe atë për vijat buxhetore në vijim:
E22 - Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe aseteve në vlerë prej € 40,000.00;
- II. Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSh GJI170 - NewCo XIM Strezovci.


Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për e22 Shërbimet për mbrojtjen e pronës. pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit NSh GJI170 - NewCo XIM Strezovci . Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 25 qershor 2026.


Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-234/17

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023, , nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 25 qershor 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për NSh GJI003 I.D.GJ. Tobacco Industry –(në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumë prej 21,000.00 € dhe atë për vijat buxhetore në vijim:
 - e14 (Shpenzimet e Gjykatës), në vlerë prej € 20,000.00;
 - e18 (Ofruesit e Shërbimeve(Pagesat Neto), në vlerë prej € 500.00;
 - e19 (Tatimi i të ardhurave personale për Ofruesit e Shërbimeve), në vlerë prej € 450.00.
